

Nr.....Prot.

Date: ___/___/2019



**KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SIGURIMIN E VETË MJETIT MOTORIK
“KASKO”**

Adresa :

Rruga e Barrikadave, Albsig HQ, 1001 Tiranë, AL, Tel 042 254 764

E-mail : info@albsig.com.al

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. TERMA TË PËRGJITHSHËM

- a. **“Siguruesi”** është shoqëria e sigurimeve **ALBSIG sh.a**, që ofron këtë kontratë vullnetare KASKO;
- b. **“I Siguruari”** do të quhet personi fizik ose juridik, i cili ka interes pasuror mbi objektin e siguruar, emri i të cilit shënohet në policën e sigurimit.
- c. **“Përfituesi”** do të quhet personi fizik ose juridik i përcaktuar në Policën e Sigurimit si perfitues i dëmshpërblimit me ndodhjen e ngjarjes të sigurimit;
- d. **“Përfaqësuesi” ose “Kontraktuesi”** do të quhet personi fizik ose juridik që ngarkohet me lidhjen dhe nënshkrimin e kontratës së sigurimit për llogari të Siguarit/ve;
- e. **“Përdorues”** kupton personat që përdorin mjetin motorik objekt sigurimi, emrat e të cilëve shënohen detyrimisht në kontratën e sigurimit apo sipas autorizimit me kusht që të kenë dhëshmi aftësie përkatëse dhe për të cilët është i vlefshëm mbulimi;
- f. **“Mjet motorik”** do të kuptojmë një mjet që lëviz mbi tokë, me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave. Mjete motorike do të quhen edhe rimorkiot ose gjysëm rimorkiot, pavarësisht nëse janë të bashkuara apo jo me mjetin motorik tërheqës;
- g. **“Rrugë”** do të quajmë zonën e përdorimit publik sipas kuptimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë;
- h. **“Qarkullim Mjeti”** do të kuptojmë lëvizjen, ndalimin dhe qëndrimin e mjetit në rrugë, sipas kuptimit të Kodit Rrugor të Republikën e Shqipërisë;
- i. **“Vëndqëndrimi i Mjetit”** do të kuptojmë vendin ose ambientin ku mjeti është në gjëndje pushimi natën ose vendi prej ku mjeti fillon zakonisht qarkullimin, si vendbanimi, qendra e punës e të Siguarit ose vendi i parkimit të deklaruar nga i Siguruari në “Kërkesë/Pyetsorë”;
- j. **“Kushtet e Sigurimit”** kupton kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës për sigurimin Kasko të mjeteve motorike të pranura dhe nënshkruara nga palët;
- k. **“Rast Sigurimi”** do të kuptojmë ngjarjen e parashikuar sipas mbulimeve të më poshtme për të cilat “Siguruesi” dëmshpërblen për dëmet e ndodhura;
- l. **“Pjesa e Zbritshme”** është kusht kontraktor i vendosur mes palëve që përcakton përgjegjësinë e përbashkët për pagimin e dëmit. Ajo shprehet në % dhe shënohet në kontratë;

2. OBJEKTI I KONTRATËS SË SIGURIMIT

Siguruesi, në bazë të mbulimeve të parashikuara në këtë kontratë e çdo shtojcë të saj të nënshkruar nga palët, merr përsipër të dëmshpërblejë të Siguarin apo përfituesin lidhur me humbjen apo demtimin e plotë ose të pjesshëm të mjetit motorik të siguruar, në mënyrë të papritur të paparashikuar dhe aksidentale;

3. SHTRIRJA TERRITORIALE

- a. Kjo kontratë është e vlefshme për dëmet që ndodhin në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës;
- b. Siguruesi mund të zgjerojë shtrirjen territoriale të policës së sigurimit, përkundrejt pagimit të një primumi shtesë. Zgjerimi i shtrirjes territoriale nuk mund të kalojë kufijnjtë e kontinentit Europian ku perjashtohet Republika e Bosnje Hercegovines. Gjithashtu, afati kohor i vlefshmërisë nuk mund të kalojë periudhën e vlefshmërisë së kësaj police;

4. PERIUDHA E SIGURIMIT

- a. Periudha e sigurimit është e përcaktuar në kontratë e cila është (1) njëvjeçare, përveç rasteve kur në policën e sigurimit përcaktohet ndryshe;

- b. Mbulimi në sigurim, hyn në fuqi në orën 24.00 të datës së përcaktuar si datë fillimi në kontratë, me kushtë që të jetë paguar primi i sigurimit, dhe përfundon në orën 24.00 të datës së përcaktuar si datë mbarimi të mbulimit në sigurim në Policën e Sigurimit;
- c. Kontrata e sigurimit nuk rinovohet në heshtje. Në rates të veçanta afati i kontratës mund të jetë më i shkurtër se një (1) vit, por jo më pak se tre (3) muaj;
- d. Në rastin e sigurimit të interesit të Kredihënësit mbi mjetin motorik objekt sigurimi, afati I vlefshmërisë së kontratës mund të përputhet me afatin e shlyerjes së kredisë, megjithatë ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se pesë vjet;

5. PRIMI I SIGURIMIT

- a. *Primi i Sigurimit* është vlera në monedhë e zgjedhur nga palet, “*Tarifa*” e të cilit përcaktohet në bazë të llogaritjeve, sipas mbulimeve të zgjedhura, klasifikimit dhe veçorive të mjetit motorik, si dhe të Siguruarit e përdoruesve;
- b. Primi i sigurimit paguhet njëherësh ose me këste me numër, vlerë dhe kohë maturimi sipas përcaktimit paraprak të palëve dhe shënohet në kontratë. Si rregull kontratat me afat vlefshmërie një vjeçar paguhet njëherësh;
- c. Paga, do të quhet e kryer, në momentin e kalimit të vlerës monetare të primit në llogarinë e *Siguruesit*;
- d. Nëse primi i sigurimit ose kësti i parë i tij nuk është paguar në momentin e ndodhjes së ngjarjes së siguruar, kontrata është e pavlefshme;
- e. Në çdo rast pas përfitimit nga i Siguruari të një dmëshpërblimi për dëme të pjesshme nga kjo kontratë, dhe kur Siguruesi pranon rivendosjen e kontratës në termat fillestarë të mbulimit lidhur me shumën e siguruar, i Siguruari do të paguajë një prim shtesë proporcional, në varësi të kësaj shume, për rivendosjen e kontratës për kohën e mbetur deri në përfundim të saj. Në rast të kundërt Siguruesi gëzon të drejtën e reduktimit të vlerës së dëmit me koeficient nënsigurimi;

6. MBULIMET E SIGURUARA DHE PËRJASHTIMET E VEÇANTA

6.1 DËMTIMI AKSIDENTAL (*përplasja , përmbysja , mjete motorik i parkuar*)

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorik gjatë qarkullimit apo qëndrimit të tij nga:

- a. **Përplasja** me një objekt fiks ose të lëvizshëm.
- b. **Përmbysja** e mjetit motorik shkaktuar si pasojë e përgjegjësisë së drejtuesit të mjetit me cilësinë e të Siguruarit;
- c. Dëmtimi i mjetit kur ndodhet i parkuar në një vend të caktuar dhe nuk mund të identifikohet shkaktari i aksidentit. Dëmet të tilla përfshijnë, të gërvishurit me mjete të forta, nullojse apo shtypje të çdo pjesë të sipërfaqes së jashtme të mjetit;
- d. Dëmtimi i mjetit kur ndodhet i parkuar Siguruesi do të paguajë dëmet e shkaktuara mjetit të siguruar kua ai ndodhet në një vend të përcaktuar si parkim edhe në rastet kur shkaktari i dëmit është i paidentifikuar deri në vlerën **50,000lek**. I siguruari detyrohet të bëjë foto të vendgjarjes dhe mjetit të dëmtuar dhe t’i depozitojë ato pranë siguruesit, në të kundërt siguruesi gëzon të drejtën të çlirohet nga dmëshpërblimi;

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim:

- a. Dëmet që i shkaktohen mjetit motorik në qarkullim kur drejtohet nga një përdorues tjetër i ndryshëm nga i/të Siguruari/it e shënuar në policë.
- b. Dëmet në mjetin motorik të siguruar, si rezultat i konsumit normal, defekteve apo avarive të brëndëshme elektrike apo mekanike të mjetit që është neglizhuar në riparimin e tyre.

- c. Dëmet e shkaktuara mjetit motorrik të siguruar qe synojnë shkatërrimin e pronës me zjarr apo eksploziv të qëllimshëm apo me mjete të tjera dhe të cilat konsiderohen e trajtohen si “Akte Keqdashese”.

6.2 MBULIMI I TRANSPORTIT ME KARROATREC

Siguruesi do të mbulojë shpenzimet e transportit me karroatrec të mjetit motorik nga vendi i ngjarjes deri në vendin e përcaktuar nga i siguruari, vetëm për ato raste sipas përcaktimeve të pikës 6. Dhe kur mjeti motorik nuk mund të lëvizë si pasojë e dëmtimeve të rënda;

6.3 THYERJA E XHAMAVE

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorrik nga:

- a. Plasaritja deri tek thërmimi i xhamave të përparme, të pasëm, anësor, të tavaneve të lëvizshëm si dhe xhamave të fenerëve të shkaktuar nga goditja e një objekti të lëvizshëm;

Nuk demshperblehen nga ky mbulim ne sigurim:

- a. Dëmet në çdo xham tjetër që nuk përfshihet në katalogun e prodhimit, por që është vendosur si aksesori në mjetin motorik;
- b. Dëmet e shkaktuara në mbulesat ose perdet mbrojtëse nga dielli të montuara në xhama nga vetë i Siguruari;
- c. Thyerja e xhamit si pasojë e vjedhjes ose tentativës për vjedhje;

6.4 ZJARRI, EKSPLOZIONI DHE RRUFEJA

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorrik nga:

- a. **Zjarri dhe Eksplozioni** që vijnë nga faktorë të jashtëm që vetpërhapen dhe përfshijnë mjetin e siguruar;
- b. **Rrufeja** që godet direkt mbi mjetin motorik;

Nuk demshpërblehen nga ky mbulim në sigurim:

- a. Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo eksplozioni, që vijnë nga shkaqe të brendshme të mjetit motorik;
- b. Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo eksplozioni ku shkak ka qënë pirja e duhanit në mjetin motorik;
- c. Dëmet e shkaktuara nga zjarri dhe eksplozioni, ciladoqoftë natyra dhe origjina e tyre, nëse nuk është njoftuar Reparti i PMNZSH-së;
- d. Dëmet e shkaktuar ne mjetin motorrik te siguruar nga persona te painedentifikuar;

6.5 KATASTROFA NATYRORE

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorrik nga:

- a. **Stuhia, breshëri, dëbora, tufani, përmbytja, vërshimi**, kur katastrofa natyrore është e njohur dhe e deklaruar si e tillë nga autoritetet përkatëse shtetërorë;
- b. Dëmet e shkaktuara në mjetin motorrik të siguruar nga rënia e objekteve të ndryshme,që ndodhin si pasojë e katastrofave natyrore;
- c. Dëmet në mjetin motorrik të siguruar, shkaktuar nga përmbytja e garazhit si rezultat i çarjes së tubacioneve të ujrave edhe në rast se nuk ka ndodhur katastrofë natyrore;

Nuk demshpërblehen nga ky mbulim në sigurim:

- a. Dëmet nga tërmeti dhe rrëshqitja e tokës;
- b. Dëmet e shkaktuara gjatë kalimit nëper lumejve, përrejve, futjes në pellgje të mëdha uji;

6.6 VJEDHJA

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorrik nga:

- a. **Vjedhja:** Do të konsiderohet veprimi i përvetësimit në mënyrë të fshehtë, nga një ose disa persona, i mjetit motorik të siguar (vjedhje totale) kallzuar dhe vërtetuar nga organet e Rendit Publik dhe Prokuroria;
- b. **Tentativa për vjedhje:** Do të konsiderohet çdo veprim që ka synuar vjedhjen e mjetit motorik të siguar ose të pjesëve të tij por që nuk ka arritur të kryhet, duke shkaktuar dëme ndaj mjetit motorik. Këtu mbulohen vetëm dëmet e shkaktuara mjetit motorik si pasojë e tentativës për vjedhje të vërtetuar nga organet e Rendit Publik dhe Prokuroria;

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim:

- a. Dëmet nga vjedhja nëse ato janë kryer nga i Siguruarit ose përdoruesit, nga punonjësit e shërbimit, ruajtjes apo të mbikqyrjes të vendit të punës apo parkimit;
- b. Dëmet nga vjedhja ose tentativë vjedhje kur nuk janë mbyllur mirë dyert, tavani i lëvizshëm, xhamat ose çelësat e mbylljes janë lënë brenda mjetit, mbi ose përreth tij;
- c. Dëmet nga vjedhja e pjesëve me shkaqe të pashpjegueshme pa shënja e gjurmë të dukshme që vërtetojnë se ka ndodhur vjedhja;
- d. Kur i siguruarit nuk ka njoftuar për humbjen e kopjes së çelësit ose nuk i dorëzon Siguruesit të gjitha kopjet e çelësve të mjetit motorik sipas katalogut të fabrikës së prodhimit;
- e. Vjedhja e pjesëve apo aksesorëve të jashtëm dhe të brendshëm të mjetit si: pasqyra, autoradio, antenna, telefon, autoparlante, fshirëse xhamash, kroskot, parakolp, dyer, airbag, televizor, sisteme navigator, sensor parkimi, tasa të gomave, gomat, disqet e gomave, targat e mjetit motorik, e të ngjashme me to, përveç kur kemi vjedhje totale të mjetit motorik të siguar;
- f. Vjedhja e mjetit me dhunë që nënkupton përdorimin e armëve, imitacioneve të tyre apo dhe mjete të tjera të dhunës nga persona të identifikuar apo të paidentifikuar të çilët vën nën kërcënim jetën dhe shëndetin e zotëruesit të mjetit me cilësinë e të Siguarit;
- g. Vjedhja e Mjetit motorik kur ngjarja e siguar ka ndodhur jashtë Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës;

7. MBULIMET SHITESË DHE PËRJASHTIMET E TYRE

Siguruesi do të ofrojë të Siguarit mbulimet shtesë sipas Nenit 7.1 dhe 7.2 me kërkesë të të Siguarit kundrejt pagesës së primit shtesë duke lëshuar shtojcë police/kontrate me mbulimet dhe perjashtimet e secilës prej mbulimeve shtesë.

7.1 VJEDHJA E PJESSHME

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorik nga:

- a. ***Vjedhja e Pjesshme:*** Do të konsiderohet veprimi i përvetësimit në mënyrë të fshehtë i pajisjeve/aksesorëve si (autoradio, kroskot, parakolp, airbag, sensor parkimi, televizor, sistem navigatori, antena, targat dhe dyert) të mjetit motorik të siguar (vjedhje e pjesëve) të vërtetuar nga organet kompetente shtetërore (Prokuroria);
- b. ***Tentativa për vjedhje të pjesëve:*** Do të konsiderohet çdo veprim që ka synuar vjedhjen e pjesëve të mjetit motorik të siguar, por që nuk ka arritur të kryhet duke shkaktuar dëme ndaj pjesëve të mjetit motorik si (autoradio, kroskot, parakolp, airbag, sensor parkimi, televizor, sistem navigatori, antena, tasa të gomave, disqet e gomave, targat, pasqyrat e jashtëme dhe dyert). Këtu mbulohen vetëm dëmet që i janë shkaktuar pjesëve të mjetit motorik si pasojë e tentativës për vjedhje të pjesëve të vërtetuar nga organet kompetente (Prokuroria);

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim:

- a. Dëmet nga vjedhja nëse ato janë kryer nga i Siguruarit ose përdoruesit, nga punonjësit e shërbimit, ruajtjes apo mbikqyrjes të vendit të punës apo parkimit;
- b. Dëmet nga vjedhja e pjesëve ose tentativë vjedhje kur nuk janë mbyllur mirë dyert, tavani i lëvizshëm, xhamat ose çelësat e mbylljes janë lënë brenda mjetit, mbi ose përreth tij, kur mjeti është parkuar në rrugë të painventarizuara sipas Nenit 1 (g) të kushteve të përgjithshme të

sigurimit KASKO. Në rastin e ndodhjes së kësaj ngjarje sigurimi i Siguruari është i detyruar ti dorëzojë Siguruesit të gjitha kopjet e çelësave. Gjithashtu, i Siguruari duhet të deklaroj çdo humbje të çelësit të makinës tek Siguruesi, në rast të kundërt Siguruesi nuk mban përgjegjësi për rastin e sigurimit;

- c. Vjedhja e pjesshme e pjesëve ose aksesorëve si (tasa të gomave, disqet e gomave, pasqyrat e jashtëme) si dhe aksesorë të cilët nuk janë të përmendura në Nenin 7.1 (a,b) të kushteve të përgjithshme;
- d. Vjedhja totale e mjetit motorrik te siguruar;
- e. Dëmet e pjesëve apo aksesorëve të mjetit motorrik të cilat janë vendosur vetë nga i Siguruari dhe që nuk janë pjesë integrale të mjetit dhe pjesë e katalogut të prodhimit;

7.2 AKTE KEQDASHËSE

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorrik nga:

- a. Dëmet e shkaktuara nga veprimet e dhunëshme, të qëllimshme e të vullnetshme të individëve të motivuar nga dashakeqësia, që me zjarr, eksplozion ose mjete të tjera dëmtojnë ose shkatërrojnë mjetin objekt sigurimi përgjatë qarkullimit të tij (lëvizjes, ndalimit, qëndrimit) në rrugë;

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim:

- a. Veprimet e të Siguararit ose të nxitura e udhëzuara nga i Siguruari, të afërmit ose punonjësit e tij;
- b. Lufta, lufta çivile, rebelimi, revolucioni, kryengritja, puçi ushtarak, veprimet e fuqive ndërluftuese pavarësisht nëse lufta është deklaruar ose jo, aktet terroriste;
- c. Grevat (ndërprerja e punës), konfiskimi ose shkatërrimi i qëllimshëm i mjetit me urdhër të Autoritetit shtetëror, si dhe nga rrezatimi jonik ose ndotja radioaktive;

8. PËRJASHTIME TË PËRGJITHSHME ÇFARE NUK ESHTE E MBULUAR:

Siguruesi, nuk do të dëmshpërblejë, humbjet apo dëmtimet, që pëson mjete motorrik, në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekt, janë shkaktuar, rrjedhin ose janë rënduar gjatë, në ose nga:

- a. Dëmet e shkaktuara qëllimisht dhe/ose të udhëzuara nga personi i Siguaruar;
- b. Dëmet që rezultojnë nga çdo akt i luftës, invazionit, veprimeve të tjera të armatosura pavarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo, lufta çivile, turbullira çivile, revolucione, lëvizja separatiste, kryengritja popullore, rebelimit, revolta, puçe, grushte shteti, eksode, akteve terroriste, trazirave, grevës, sabotimit;
- c. Dëmet që vijnë si rezultat i shpërthimit bërthamor, rrezatimit bërthamor, ndotjes radioaktive, rrezatimeve jonizuese, ndotjeve kimike;
- d. Dëmet që shkaktohen nga shkelja e normave të qarkullimit rrugor e klasifikuar “pakujdesi e rëndë”, për të cilat Kodi Rrugor parashikon masën e heqjes së lejes së drejtimit për drejtuesin e mjetit;
- e. Dëmet e shkaktuara qëllimisht ose i udhëzuar nga i Siguruari, familjarët dhe/ose punonjësit ose agjentët e tij. Veprimet ose kundraveprimet keqdashëse dhe të kundraligjshme të nxitura ose provokuara nga i Siguruari, familjarët apo punonjësit e agjentët e tij, ose përfshirja e tyre në to, pa vullnetin e tyre;
- f. Drejtuesi nuk e përdor mjetin në përputhje me qëllimin për të cilin ai është i destinuar të përdoret, nuk ka leje të vlefshme të drejtimit të mjetit motorrik sipas kategorisë apo tipit të mjetit, i është tërhequr ose pezulluar nga autoriteti kompetent leja e drejtimit të mjetit në momentin që ndodh ngjarja e sigurimit, apo i ndalohet përdorimi i lejes së drejtimit të lëshuar nga një Shtet tjetër, për territorin e Republikës së Shqipërisë;
- g. Dëmet në mjetin e siguruar, të bllokuar ose në tentativë bllokimi nga Organet e Shtetit;
- h. Dëmet që shkaktohen nga përdorues emrat e cilëve nuk janë shënuar sipas Nenit 1(e);

- i. Dëmet që rezultojnë nga konsumi normal, defektet apo avaritë e brendshme elektrike apo mekanike gjatë ndezjes ose lëvizjes së mjetit;
- j. Prerja apo skopjimi i gomave, por jo dëmet që pasojnë;
- k. Dëmet në mjetin motorik të siguruar në operaçione të tilla si: shërbimi, riparimi, kontrolli, larja, parkimi, dorëzimi ose shitja;
- l. Dëmet e shkaktuara nga përdoruesit, të pa pajisur me dëshminë e aftësisë për drejtimin e mjetit dhe kur keta janë të shenuar në policën e sigurimit apo familjare të Siguruarit;
- m. Dëmet e shkaktuara kur drejtuesi i mjetit ndodhet nën ndikimin e efekteve të alkoolit e të drogës ose refuzon t'i nënshtrohet provave të këtij kontrolli;
- n. Dëmet ose humbjet e objekteve, sendeve personale, mallrave ose bagazheve që ndodhen në mjet në momentin e rastit të sigurimit;
- o. Siguruesi nuk do të mbulojë zmadhimin e humbjeve ose dëmeve për shkak të neglizhençës të të Siguruarit ose mosmarrjes së masave parandaluese që të mos thellohen ato. Siguruesi do të paguajë shpenzimet e arsyeshme të bëra që nuk lejojnë që të zmadhohen dëmet ose humbjet;
- p. Dëmet që zmadhohen artificialisht nga i Siguruarit për kalimin e vlerës të franshizës, me qëllim përfitimin e mbulimit në sigurim;
- q. Dëmet që shkaktohen kur mjeti qarkullon jashtë rrugë apo vende të cilat nuk quhen rrugë sipas përcaktimeve të Kodit Rrugor;
- r. Dëmet e shkaktuara nga metarialet, lëndët e rrezikshme apo kafshët që transportohen me këtë mjet;
- s. Dëmet e shkaktuara pjesëve të automjetit të cilat janë vendosur vetë nga i Siguruarit dhe nuk janë pjesë e katalogut të prodhimit të automjetit;
- t. Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për humbjen e mjeteve të cilat rezultojnë të vjedhura më parë jashtë teritorit të Shqipërisë;
- u. Në çdo kërkesë, padi ose procedurë tjetër gjyqësore ku Siguruesi deklaron se, sipas parashikimeve të mësipërme, humbja apo dëmtimi nuk mbulohet në sigurim, barra për të provuar që kjo humbje, shkatërrim, dëmtim apo përgjegjësi mbulohet, do të takojë të Siguruarit;
- v. Mosvendosja e zinxhirëve të dëborës në kushte moti të cilat detyronin drejtuesin e mjetit që të vendoste ato, si dhe qarkullimi i mjeteve me defekte teknike, kur drejtuesi i mjetit kishte dijeni ose duhej të kishte dijeni për to;
- w. Fitimin e munguar;

9. POLICA E SIGURIMIT

a. *Siguruesi*, i dorëzon *të Siguruarit*, një dokument të firmosur nga ana e tij, *Policën e Sigurimit*, e cila vërteton, pranimin e *Kushteve të Përgjithshme* nga *i Siguruarit* si dhe lidhjen e *Kontratës së Sigurimit*;

b. Polica e sigurimit, lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim të të *Siguruarit* "Pyetësi". *Siguruesi*, lëshon Policën e Sigurimit dhe përçakton primin e sigurimit, në bazë të njoftimeve dhe deklarimeve të bëra nga *i Siguruarit* "Pyetësori". Kërkesat, njoftimet dhe deklaratimet e tjera të *të Siguruarit*, i bashkëngjiten dhe janë pjesë e Policës së Sigurimit;

c. *I Siguruarit*, është përgjegjës, lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të bëra prej tij;

d. *Siguruesi*, ka të drejtë të verifikojë vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të *të Siguruarit* dhe të kryejë inspektime për saktësime të dhënash;

e. Kur, Polica e Sigurimit, humbet ose dëmtohet, në masën që bëhet e pavlefshme, me kërkesën dhe shpenzimet e *të Siguruarit*, *Siguruesi*, duhet të lëshojë një dublikatë të saj;

f. *Kërkesa për Sigurim*. Kupton kërkesën e të Siguruarit për sigurimin e mjetit të tij duke i dhënë përgjigje formularit standart të përgatitur nga Siguruesi. I Siguruarit ose personi i autorizuar nga ai, nënshkruan së bashku me agjentin ose inspektorin e marrjes në sigurim kërkesën për sigurim dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e deklarimeve të bëra në të. Pas plotësimit të kërkesës për sigurim, i

Siguruari nuk mund të kryejë ose lejojë ndryshime që sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Me shtim të rrezikut kuptohen rrethanat që janë thelbësore të cilat mund të influencojnë në vendimin e Siguruesit për të lidhur ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë;

g. Në rast të moszbatimit të kushtit të mësipërm, Siguruesi çlirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit;

h. Natyra dhe Shtrirja. Kontrata e sigurimit përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, natyrën dhe shtrirjen e mbulimeve si dhe ndryshimet e primeve që rezultojnë nga ndryshimi i faktorëve të rrezikut. Ajo nënshkruhet nga të dy palët, Siguruesi dhe i Siguruari ose personat e autorizuar prej tyre dhe lëshohet pas pagesës së primit të sigurimit, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe;

i. Kalimi i të Drejtave. Të drejtat dhe detyrimet e të Siguarit në këtë kontratë nuk mund të kalojnë tek një person tjetër pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Ky miratim do të shoqërohet me ndryshimet përkatëse në kontratën e sigurimit. Çdo parashikim apo pretendimin i ndryshëm me parashikimin e paragrafit të parë të kësaj pike është i pavlefshëm dhe e çliron Siguruesin nga detyrimi për mbulim në sigurim;

10. APLIKIMI I SISTEMIT BONUS – MALUS

a. Në rinovimet e kontratave për mjetet që kanë përfituar dëmshpërblim nga sigurimi KASKO , do të aplikohet MALUS që nënkupton rritje të primit të sigurimit e cila do të jetë në masën 15 % të primit të llogaritur;

b. Në rinovimet e kontratave për mjetet që nuk janë përfshirë në aksidente, pra nuk kanë përfituar dëmshpërblim sipas kontratës KASKO, do të aplikohet BONUS që nënkupton zbritje (ulje), ulje e cila do të jetë në masën 10% të primit të sigurimit;

11. ZGJIDHJA DHE PËRFUNDIMI I POLICËS SË SIGURIMIT

11.1 Kontrata e sigurimit, është e pavlefshme, nëse vërtetohet se ,rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar ose ka pushuar së qeni para lidhjes së kontratës;

Siguruesi do të zgjidhë kontratën e sigurimit në qoftë se:

a. Nuk është paguar kësti vijues i primit të sigurimit, ose primi i sigurimit për kontratat e rinovuara. Data e zgjidhjes do të jetë 15 ditë pas mbarimit të afatit të pagimit;

b. Ka të dhëna për pasaktësi të informacionit të dhënë nga I Siguruari;

11.2 I Siguruari mund ta zgjidhë kontratën:

a. Duke njoftuar 30 ditë përpara datën e zgjidhjes;

b. Kur të Siguarit ose përdoruesit të mjetit motorik iu është hequr dëshmia e aftësisë gjatë muajve të fundit;

11.3 Kontrata e sigurimit, përfundon:

a. Nëse, rreziku i sigurimit (mjeti) pushon së qeni pas lidhjes së kontratës , kontrata e sigurimit zgjidhet dhe ka të drejtën e arkëtimit të primit, për të gjithë periudhën e sigurimit;

b. Me shqyrtimin e kërkesës për dëmshpërblim, të paraqitur nga *i Siguruari* , *Siguruesi*, ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit, duke i kthyer *të Siguarit* , pjesën e primit, në përputhje me tabelën e kthimit te primit. *Siguruesi*, mund të zgjidhë kontratën (kontratat) për një ose disa mjete të të njëjtit *të Siguarit*;

11.3 Kur pas lidhjes të kontratës të sigurimit pushon interesi pasuror i të Siguarit (transferohet pronësia), kontrata e sigurimit quhet e zgjidhur;

12. DETYRIME

12.1 DETYRIMET E TË SIGURUARIT:

- a. *I Siguruari*, është i detyruar të paguajë primin e sigurimit në masën dhe kohën e rënë dakord mes palëve;
- b. *I Siguruari* duhet të njoftoj menjëherë Siguruesin për ndodhjen e rastit të sigurimit. Sipas kësaj kontrate të njoftosh menjëherë ndodhjen e ngjarjes do të thotë të njoftosh Siguruesin jo më vonë se 48 orë nga momenti i ndodhjes së ngjarjes së sigurimit ose marrjes në dijeni për ndodhjen e saj. Në pajtim me natyrën e ngjarjes së sigurimit të njoftojë menjëherë, brenda 24 orësh, organin kompetent, si Policinë rrugore (për Aksidentet), Policinë e Rendit (për vjedhjen) dhe PMNZSH (për rënien e zjarrit), si dhe ti paraqesë Siguruesit vërtetimet e këtyre organeve për njoftimet apo denoncimet e kryera;
- c. *I Siguruari*, duhet të informojë me shkrim *Siguruesin*, për të gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe që janë thelbësore për vlerësimin e rrezikut. Rrethanat, konsiderohen thelbësore, nëse *i Siguruari* është pyetur me shkrim nga *Siguruesi*, ose ato janë të një natyre të tillë, që mund të influençojnë në vendimin e *Siguruesit*, për të lidhur ose refuzuar kontratën, apo për kushtet që do të vendosë;
- d. *I Siguruari*, pas lidhjes së Kontratës së Sigurimit, duhet të njoftojë me shkrim çdo ndryshim në mjetin motorik, që sjell si pasojë rritjen e rrezikut;
- e. *I Siguruari*, duhet të ndër marrë hapa të arsyeshëm, për të mbrojtur nga dëmtimet apo humbjet mjetin motorik, duke e mbajtur në kushte të sigurta dhe efikente;

12.2 DETYRIMET E SIGURUESIT:

- a. *Siguruesi*, ka të drejtë të zgjidhë Policën e Sigurimit brenda 45 ditëve nga fillimi i saj, për shkak të pasaktësisë së informacionit të dhënë nga *i Siguruari*. Në këtë rast, *i Siguruari*, nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e primit të sigurimit;
- b. *Siguruesi*, ka të drejtë, nga çasti i shtimit të rrezikut, të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, afatin e sigurimit, ose të zgjidhë kontratën. Mosnjoftimi nga *i Siguruari*, sjell si pasojë çlirimin e *Siguruesit* nga detyrimi për pagesën e dëmshpërblimit;
- c. *Siguruesi* duhet hartojë kontratën dhe dëshminë e lidhjes së saj policës së sigurimit sipas formës ligjërisht të vlefshme;
- d. *Siguruesi* duhet të lëshojë dublikatë police në rast të humbjes ose bërjes së pa përdorshme të policës së sigurimit;

13. SHUMA E SIGURUAR

- a. Mjeti motorik, i treguar në policën e sigurimit, mbulohet në sigurim, për një shumë të siguruar, e cila përcaktohet në marrëveshje midis *Siguruesit dhe të Siguarit*;
- b. Shuma e siguruar, mund të jetë e barabartë me vlerën e blerjes së mjetit motorik të ri, kur ky merret në sigurim në momentin e vënies në qarkullim për herë të parë, ose me vlerën e tregut.
- c. Në rast se, të dy palët bien dakord, që shuma e siguruar të jetë më e vogël se vlera e tregut të mjetit motorik, do të kemi nën sigurim dhe do të zbatohen procedurat e seksionit "*Nënsigurimi*";

14. DYSIGURIMI

- a. Nëse, *i Siguruari*, kryen një tjetër sigurim (dysigurim) për mbulimin e rreziqeve në përputhje me këto Kushte të Përgjithshme, ai duhet t'i komunikojë *Siguruesit* të parë, emrin e Siguruesit tjetër si edhe shumën e siguruar;
Në rast se, qëllimisht apo për shkak të neglizhencës, *i Siguruari*, nuk plotëson detyrimet sipas paragrafit të mësipërm, *Siguruesi*, ka të drejtë të zgjidhë *Policën e Sigurimit* dhe të mos kthejë primin.

b. Në rastin e dysigurimit, masa e dëmshpërblimit nga të dy kontratat, nuk mund të jetë më e madhe se vlera e humbjes duke zbritur pjesën e zbritshme;
Nëse, *i Siguruari*, kryen sigurime të tjera me qëllim që, të arrijë përfitime të paligjshme, kontrata e sigurimit, quhet e pavlefshme dhe *Siguruesi* mban primin e sigurimit;

15. NËNSIGURIMI

a. *Siguruesi* dhe *i Siguruari*, mund të bien dakord për sigurimin e mjetit motorrik për një *Shumë Sigurimi* më të vogël se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorrik të ri;

Në këtë rast, dëmshpërblimi që do të përfitojë *i Siguruari*, do të llogaritet duke shumëzuar, vlerën e dëmit me koeficientin e nënsigurimit. Koeficienti i nënsigurimit, është raporti i shumës së siguruar kundrejt vlerës së tregut apo të blerjes së mjetit motorrik të ri;

b. Nënsigurimi, do të zbatohet, edhe nëse në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, shuma e siguruar, është më e ulët se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorrik të ri;

16. MBISIGURIMI

a. Nëse, Shuma e Siguar, është përcaktuar më e lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit mjet motorrik të ri, *Siguruesi* dhe *i Siguruari*, kanë të drejtë të bëjnë ndryshimet përkatëse në Policën e Sigurimit, duke zvogëluar si Shumën e Siguar ashtu dhe Primin e Sigurimit;

b. Në çdo rast, kufiri i përgjegjësisë së *Siguruesit*, nuk do të jetë më i lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit tip mjet motorrik, duke zbritur pjesën e zbritshme;

c. Nëse, *i Siguruari*, lidh kontratën e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. *Siguruesi*, ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit;

17. PJESA E ZBRITSHME DHE FRANSHIZA

Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, do të zbatohet pjesa e zbritshme dhe (ose) franshizë. Masa e pjesës së zbritshme dhe franshizës, vendosen në policën e sigurimit.

a. Për çdo rast dëmi Siguruesi, do të zbrisë nga shpërblimi i llogaritur, Pjesën e Zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit në shumë absolute apo përqindje dhe e cila është ajo pjesë e dëmit që përballohet nga klienti;

b. Siguruesi, nuk do paguaj dëme të veçanta, që janë nën shumën e përcaktuar si Franshizë në kontratën e sigurimit;

18. NDRYSHIMI I SHUMES TE SIGURUAR

Mbas pagesës së çdo dëmi shuma e siguruar e mjetit motorrik qëndron e siguruar deri në fund të afatit të caktuar në policën e sigurimit Kasko për një “shumë të re sigurimi” e barabartë kjo me diferencën e shumës të sigurimit fillestar dhe vlerës të dëmshpërblimit, pra për një dëm të dytë, i Siguruari do të dëmshpërblehet sipas shumës të re të sigurimit, pra me nënsigurim;

19. NJOFTIMI I RASTIT TË SIGURIMIT DHE DËMSPËRBLIMI

Është kusht parësor për përgjegjësinë e *Siguruesit*, që për çdo ngjarje që mund të jetë shkak, për kërkesë për dëmshpërblim, *i Siguruari*, menjëherë duhet:

a. Të njoftojë *Siguruesin* dhe *Perfituesin*, duke specifikuar rrethanat e ngjarjes. Një njoftim i tillë, do të konsiderohet i dhënë *Siguruesit*, nëse është dhënë brenda 48 orëve nga ndodhia e ngjarjes;

b. Në rastin e ndodhjes së aksidentit, *i Siguruari*, detyrohet menjëherë të njoftojë sipas rastit të sigurimit, Policinë Rrugore, të Rendit, Zjarrfikësat brenda një afati prej 24 orësh nga momenti i ndodhjes apo konstatimit të tij dhe të vërë në dispozicion të *Siguruesit*, vërtetimin e autoriteteve të lartpërmendura, lidhur me njoftimin e bërë;

c. Të plotësojë formularin “Vërtetim Miqësor i Ngjarjes, Njoftim i Rastit të Sigurimit” dhe t’ia paraqesë atë *Siguruesit*, të shoqëruar me të gjitha të dhënat identifikuese përkatëse të mjetit motorrik, të dëmtuar apo humbur, si dhe rrethanat përkatëse të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Formulari

standart i njoftimit të rastit të sigurimit, duhet të plotësohet me besnikëri dhe në afatet e mësipërme, pa shtrëmbërime të fakteve të rastit të sigurimit nga *i Siguruari*. Në rast të kundërt, *Siguruesi*, ka të drejtën të çlirohet nga detyrimet për pagesën e dëmit. Të shmangë dhe minimizoj humbjet ose dëmtimet aq sa është e mundur;

d. I Siguruari, për dëmet në mjetin e siguruar, paraqet kërkesë për dëmshpërblim brenda afateve të parashikuara nga Kodi Civil, vetëm pasi ka bërë njoftimin e rastit të sigurimit nëpërmjet formularit standart;

e. Siguruesi, gëzon të drejtën të çlirohet nga detyrimet e tij për dëmshpërblim nëse *i Siguruari*, me qëllim apo për neglizhencë, nuk zbaton tërësisht apo pjesërisht detyrimet e tij;

f. i Siguruari, përpiqet të paraqesë në mënyrë të shtrëmbër ose mashtruese, faktet para *Siguruesit*, fakte të cila kanë rëndësi për mundësinë dhe {ose} masën e dëmshpërblimit;

g. Siguruesi, ka të drejtë, të verifikojë rrethanat në të cilat ka ndodhur Rasti i Sigurimit, si edhe të kryejë ekspertizën e dëmit apo të humbjeve në mjetin motorrik të siguruar, brenda 15 ditësh nga dita e njoftimit të ngjarjes së sigurimit. Gjatë kësaj periudhe, *i Siguruari*, është i detyruar të mbajë mjetin motorrik të dëmtuar në dispozicion të *Siguruesit*, pa e riparuar atë.

Siguruesi do të paguajë të *Siguarin*, *Përfituesin* ose trashëgimtarin ligjor të tij për dëmet në mjetin motorrik të siguruar, deri në limitin e përgjegjësisë, duke zbritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit. Dëmet, me vlerë më të vogël se franshiza, nuk paguhen;

h. Siguruesi, në varësi të dëmit, përcakton formën e dëmshpërblimit si mëposhtë:

- Pagesë e vlerës së dëmit;
- Riparim i mjetit të dëmtuar, në pikën e riparimit të ofruar nga *Siguruesi*;
- Zëvendësim i mjetit të dëmtuar, me një mjet tjetër analog;

Dëmshpërblimi do të jetë deri në vlerën e dëmit të ndodhur dhe në asnjë rast dëmshpërblimi nuk mund të tejkalojë limitin maksimal të përgjegjësisë të përcaktuar në policën e sigurimit/pyetësorin, pasi është hequr dhe pjesa e zbritshme e përcaktuar në policën e sigurimit;

i. Siguruesi, mund të shtyjë kohën e pagesës:

- Për aq kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të *Siguarit*, për të marrë pagesën;
- Në qoftë se, janë filluar hetime penale, në lidhje me ngjarjen e sigurimit kundër të *Siguarit*;
- Për aq kohë sa, *i Siguruari*, nuk paraqet dhe plotëson dokumentat e kërkuara nga *Siguruesi*;

j. Kur vlera e dëmit, është më e lartë se 80% e shumës së siguruar, mjeti motorik do të konsiderohet dëm total;

k. Në rastin e vjedhjes totale, **ALBSIG sh.a**, do të paguajë deri në 50% të vlerës së dëmit, brenda një periudhe prej 90 ditësh, nga dita e marrjes së njoftimit lidhur me ngjarjen e sigurimit dhe pjesën e mbetur të dëmshpërblimit me përfundimin e procedurave investiguese dhe procedurave penale;

l. Në rast se, është bërë dëmshpërblimi, deri në limitin e përgjegjësisë dhe mjeti gjendet, ai do të vihet në dispozicion të *Siguruesit*. **I Siguruari**, ka të drejtë të marrë mjetin duke kthyer pagesën që i është bërë, në rast të kundërt, *Siguruesi*, përfiton pronësinë mbi mjetin;

m. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, do të zbatohet pjesa e zbritshme dhe (ose) franshizë. Masa e pjesës së zbritshme dhe franshizës, vendoset në policën e sigurimit. Për çdo rast dëmi, *Siguruesi*, do të zbresë nga shpërblimi i llogaritur, pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit në shumë absolute ose në përqindje. *Siguruesi*, nuk do të paguajë dëme të veçanta, që janë nën shumën e përcaktuar si franshizë në kontratën e sigurimit;

n. Siguruesi, i njofton Përfituesit shumën e përllogaritur të dëmshpërblimit. *Përfituesi*, me marrjen e njoftimit e udhëzon *Siguruesin*, për mënyrën dhe destinacionin e pagesës së shumës së dëmshpërblimit;

o. Ky sigurim, nuk do të dëmshpërblejë dëme, për të cilat Përfituesi/i Siguruari përfiton dëmshpërblim nën kontrata të tjera. Bën përjashtim, pjesa e dëmit, që tejkalon shumën që do të ishte mbuluar nën kontratat e tjera, në rastin kur Polica e përcaktuar nga këto kushte sigurimi, të mos ishte në fuqi.

p. Në rast pagesë dëmshpërblimi, sipas kësaj police, *Siguruesi*, do të ketë të drejtë të përfitojë të drejtën e *Përfituesit/ të Siguarit*, për të kërkuar kthimin e shumës/të drejtave pasurore, ose të çdo të

drejte tjetër legale, ndaj çdo personi ose organizate. **I Siguruari**, do të veprojë, me të gjitha mënyrat e duhura për të siguruar këto të drejta dhe nuk do të bëjë asnjë veprim për të paragjykuar këto të drejta;

q. Pas pagesës së dëmshpërblimit, mjeti motorrik, qëndron i siguruar deri në fund të afatit të caktuar në kontratë, për një shumë të barabartë me diferencën midis shumës së sigurimit dhe dëmshpërblimit të paguar. **I Siguruari**, mund të rivendosë ,shumën e siguruar, kundrejt pagesës së primit shtesë të llogaritur nga **Siguruesi**;

r. Pjesë përbërëse dhe të pandarë të Kontratës së Sigurimit KASKO janë: Polica e Sigurimit, Kushtet e Përgjithshme në tërësi, Formulari i Kërkesës për marrje në sigurim dhe çdo dokument tjetër që i bashkëlidhet;

20. DËMSPERBLIMI E LIMITET E TIJ, PROCEDURAT, VLERËSIMI DHE PAGESA, E DREJTA E SUBROGIMIT.

Sipas kësaj kontrate me një ngjarje sigurimi do të kuptojmë, përfshirjen e mjetit në një aksident ose ngjarje automobilistike në rrugë ose fatkeqësi, përfshirë vjedhjen, pasojat e të cilit rezultojnë në një dëm ose seri dëmsh në mjetin objekt sigurimi dhe janë rrjedhojë e një shkakut dhe/ose shkaqeve të identifikueshëm e mbulueshëm nga kjo kontratë, të cilët veprojnë pa ndërprerje njëri pas tjetrit derisa përfundojnë;

20.1 Dëmshpërblimi e Limitet e tij, Siguruesi në përputhje me termat dhe parashikimet e kësaj kontrate i ofron të Siguarit me vërtetimin e rastit të sigurimit dëmshpërblim pas zbritjes së Pjesës së Zbritshme, deri në shumën e siguruar për dëmet e pësuar nga mjeti, objekt sigurimi e lidhur me të, për:

a. Dëme fizike të pjeshme ose totale ose vjedhjen e mjetit, deri në shumën e siguruar të mjetit të shënuar në policë;

b. Shpenzimet e transportimit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të mjetit të dëmtuar që nuk vetëlëviz deri në vendqëndrim ose vendin e pikës së riparimit (servisit) të rënë dakord mes palëve, ose në vendin që udhëzohet nga siguruesi;

c. Shpenzimet e ruajtjes së mjetit të dëmtuar që nuk vetëlëviz, deri në 500. lek (pesëqind lek) në 24 orë, por jo më shumë 72 orë;

20.2 Procedura, i Siguruari pasi ka kryer njoftimin e rastit të sigurimit në afatin e parashikuar nga kjo kontratë me anë të Formularit Standart, të përgatitur dhe furnizuar më parë nga Siguruesi, është i detyruar të hartojë dhe t'i dorëzojë Siguruesit një kërkesë për dëmshpërblim në të cilën përcakton dhe shumën e përshtatshme të dëmshpërblimit të kërkuar;

20.2.1 Siguruesi kryen verifikimin e rrethanave të rastit të sigurimit dhe ekspertimet e nevojshme për vlerësimin e dëmit, brenda 15 ditëve nga momenti i njoftimit, ndërkohë që mjeti mbahet detyrimisht pa u riparuar nga i Siguruari, përgjatë kësaj periudhe;

20.2.2 Siguruesi do të paguajë dëmet brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për dëmshpërblim dhe pas dorëzimit nga i Siguruari, të çdo dokumenti tjetër të nevojshëm për vërtetimin e ngjarjes së sigurimit dhe/ose vlerësimin të dëmit. Brenda të njejtit afat Siguruesi mundet të refuzojë kërkesën për dëmshpërblim me anë të një njoftimi me shkrim duke arësytuar shkakun/qet e refuzimit. Në raste të tilla barra për të vërtetuar të kundërtën është e të Siguarit;

20.2.3 Siguruesi ka të drejtë të shtyjë kohën e pagesës së dëmshpërblimit:

a. nëse fillon një çështje penale kundër të Siguarit, familjarëve ose punonjësve të tij, lidhur me ngjarjen e sigurimit;

b. për aq kohë sa i Siguruari nuk ka dorëzuar ose plotësuar dokumentet e kërkuara nga Siguruesi lidhur me vërtetimin e rastit të sigurimit ose përcaktimin e vlerës së dëmit;

c. në rastin e vjedhjes totale deri në përfundimin e procedurave investigative nga organet kompetente;

20.2.4 Në çdo rast kur kërkohet dëmshpërblim për vjedhje totale, i Siguruari është i detyruar të dorëzojë të gjithë kopjet e çelësave të kyqjes dhe/ose nisjes(startimit) të mjetit tek Siguruesi. Në të kundërt Siguruesi nuk mban përgjegjësi për rastin e sigurimit duke mos rregjistruar njoftimin për vjedhjen e mjetit;

20.3 Vlerësimi i Dëmit, Siguruesi në mënyrë të pavarur bën ekspertizën dhe përcakton vlerën e dëmshpërblimit me ekspertët e caktuar prej tij, brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë.

Në rast mosmarrëveshje, por vetëm pasi Siguruesi ka ofruar vlerësimin e tij, palët me qëllim të përsheptimit të përcaktimit të një vlere të pranueshme dëmshpërblimi autorizojnë një ekspert të pa anshëm, për riekspertimin e vlerësimit të dëmit.

Shpenzimet e ekspertit përcaktohen në momentin e autorizimit të tij, nga palët;

20.4 Pagesa e Dëmit, Siguruesi do të paguajë të Siguruarin ose trashëgimtarin e tij ligjor deri në kufirin e përgjegjësisë duke zbritur gjithmonë pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratë, për një rast sigurimi. Siguruesi njofton të Siguruarin/Përfituesin për vlerën e dëmshpërblimit dhe pret udhezimet prej tij për mënyrën e pagesës e destinacionin e saj;

20.5 Subrogimi, Siguruesi mbas pagesës së dëmshpërblimit të Siguruarit fiton dhe zevëndëson të Siguruarin në të gjitha tagrat dhe të drejtat e tij përkundrejt shkaktarit të dëmit;

21. ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarrëveshjet midis Siguruesit dhe të Siguruarit kur nuk zgjidhen me mirëkuptim zgjidhen nga Gjykata e vendit ku është lidhur Kontrata e Sigurimit;